



Arsim Janova  
ud. Kryesues i Bordit të ZRrE

George Karagutoff  
Drejtor Menaxhues, KEDS

CC: Besim Sejfiqaj, Anëtar i Bordit  
Selman Hoti, Anëtar i Bordit  
Izet Rushiti, Anëtar i Bordit  
Petrit Pepaj, Drejtor Menaxhues  
Ymer Fejzullahu, Udhëheqës i Departamentit të Tarifave

7 Shtator 2018

**Lënda: Komentet e OSSh-së ndaj Raportit Konsultativ të ZRrE-së për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Periudhën e Dytë Rregullative 2018-2022**

I nderuar z. Janova,

Ky dokument përmbledh komentet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSh-së) për Raportin Konsultativ (RK) të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRrE-së) mbi të Hyrat e Lejuara Maksimale për Periudhën e Dytë Rregullative 2018-2022, të lëshuar më 24 gusht 2018.

OSSH vlerëson mundësinë e dhënë për t'i ofruar komentet e tij ndaj çështjeve të rëndësishme të ngritura në Raportin Konsultativ (RK) të ZRrE-së dhe kërkon nga ZRrE-ja që të shqyrtojë me seriozitet qëndrimin e tij mbi çështjet e ngritura në këtë raport përpara çdo vendimi përfundimtar mbi MAR-in, për periudhën e dytë rregullative 2018-2022.

OSSH është i gatshëm që në çdo kohë të takohet me ZRrE-në për t'i diskutuar çështjet e ngritura në RK dhe kundër-argumentet e ofruara në këtë raport.

Me respekt,

  


George Karagutoff  
Drejtor Menaxhues



## **Komentet e OSSh-së ndaj Raportit Konsultativ të ZRrE-së për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Periudhën e Dytë Rregullative 2018-2022**

### **I. Hyrje**

Ky dokument përmbledh komentet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSh-së) për Raportin Konsultativ (RK) të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRrE-së) mbi të Hyrat e Lejuara Maksimale për Periudhën e Dytë Rregullative 2018-2022, të lëshuar më 24 gusht 2018.

OSSH vlerëson mundësinë e dhënë për t'i ofruar komentet e tij ndaj çështjeve të rëndësishme të ngritura në Raportin Konsultativ (RK) të ZRrE-së dhe kërkon nga ZRrE-ja që të shqyrtojë me seriozitet qëndrimin e tij mbi çështjet e ngritura në këtë raport përpara çdo vendimi përfundimtar mbi MAR-in, për periudhën e dytë rregullative 2018-2022.

OSSH do t'i paraqes argumentet ndaj të gjitha çështjeve për të cilat nuk pajtohet me qëndrimin e ZRrE-së, së bashku me të gjitha tabelat mbështetëse dhe propozimet për përshtatje. Për më tepër, edhe versionet elektronike të të gjitha tabelave do t'i ofrohen ZRrE-së, me qëllim që kjo e fundit t'i shfrytëzoj ato për qëllimet e saja.

OSSH është i gatshëm që në çdo kohë të takohet me ZRrE-në për t'i diskutuar çështjet e ngritura në RK dhe kundër-argumentet e ofruara në këtë raport.

### **II. Komentet e Përgjithshme**

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) ka publikuar për diskutim të Hyrat e Lejuara Maksimale për periudhën e dytë rregullative 2018-2022 më 24 gusht 2018, pas më shumë se 1 vit nga fillimi i procesit të shqyrtimit (15 maj 2017), dhe vetëm 4 ditë pas vendimit mbi vlerat hyrëse për Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit (WACC), cakun e humbjeve dhe jetëgjatësisë së aseteve.

ZRrE i ka dorëzuar OSSh-së më 4 korrik 2017 parametrat hyrëse të propozuara për periudhën e dytë rregullative (2018-2022) dhe ashtu siç është përcaktuar në orarin indikativ OSSh ka dorëzuar komentet mbi parametrat hyrëse menjëherë më 18 korrik 2017. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre parametrave për operimet ditore të OSSh-së dhe ndikimin e tyre në 5 vitet vijuese, OSSh më vonë ka dorëzuar edhe dokumente plotësuese si mbështetje dhe arsyetime shtesë lidhur me komentet e dorëzuara mbi parametrat hyrëse.



Ndërkohë, siç përcaktohet në orarin indikativ, OSSh ka përgatitur dhe dorëzuar në ZRrE në shtator të vitit 2017 tabelat e plotësuara raportuese sipas kërkesës së ZRrE-së, të cilat do të përdoren nga rregullatori për të përcaktuar të Hyrat e Lejuara Maksimale për 5 vitet e ardhshme (2018-2022). Meqenëse, deri në atë kohë parametrat hyrëse nuk ishin miratuar dhe duke marrë parasysh që OSSh nuk pranoi asnjë koment nga ana e ZRrE-së mbi komentet e OSSh-së të dorëzuara më 18 korrik 2017, OSSh përgatiti kostot e parashikuara për periudhën 5 vjeçare për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale bazuar në parametrat e propozuara nga OSSh për periudhën e dytë rregullative.

Për më tepër, OSSh konform rregullës së miratuar nga ZRrE ka përgatitur edhe kërkesën vjetore të kostove për të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2018 në përputhje me kërkesën e tij dorëzuar për shqyrtim 5 vjeçar (shtator 2017).

Duhet të theksohet se aplikimet e OSSh-së, si për periudhën e dytë rregullative ashtu edhe për përcaktimin e MAR-it të vitit 2018, janë përgatitur bazuar në parametrat e kërkuara nga OSSh, megjithatë parametrat e miratuara më 20 gusht 2018 janë shumë larg nga kërkesat dhe pritshmëritë e OSSh-së, prandaj zhvillimi i tërë procesit të aplikimit për kostot që do të përcaktojnë të Hyrat e Lejuara Maksimale për periudhën e ardhshme rregullative (2018-2022) bazuar në këto të dhëna është i pavlefshëm dhe i papranueshëm për OSSh-ën.

Duke marrë parasysh këtë, OSSh dorëzoi një shkresë zyrtare në ZRrE, duke kërkuar rihapjen e procesit të aplikimit për përcaktimin e kostove për të Hyrat e Lejuara Maksimale për periudhën e dytë rregullative, megjithatë kjo kërkesë nuk është marrë parasysh nga ZRrE-ja. Në këtë kuptim, në vazhdim të këtij dokumenti, OSSh përveç ofrimit të komenteve të përgjithshme mbi Raportin Konsultativ të ZRrE-së, do të argumentojë edhe disa nga ndryshimet që duhet të pasqyrohen nga ZRrE-ja, marrë parasysh situatën e re pas vendimit mbi parametrat e ZRrE-së, duke përfshirë por pa u kufizuar në: shpërndarjen e drejtë të shpenzimeve operative ndërmjet ndërmarrjeve (OSSh dhe FShU), përbërja e saktë e kostove, investimet kapitale, etj.

### III. Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes (OPEX)

Në përgjigje të komenteve të ZRrE-së mbi kërkesat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, duam të sqarojmë se siç është shpjeguar në letër-përgjigjen e dorëzuar në ZRrE në shtator të vitit 2017, kostot e operimit dhe mirëmbajtjes (OPEX) për shqyrtimin e dytë periodik parashikohet të kenë një rritje të lehtë në baza vjetore, në mënyrë që të pasqyrojnë inflacionin e çmimeve përgjatë viteve, si dhe të reflektojnë ndryshimet e reja në sektorin e energjisë, kërkesat legjislative dhe reflektimin e kostove aktuale.

OSSH nuk ka parashikuar asnjë faktor efikasiteti, meqenëse në periudhën e parë rregullative, ZRrE tashmë kishte parashikuar një faktor efikasiteti prej 5% në baza vjetore, apo 10% gjithsej, gjë që ka zvogëluar mundësinë e kursimeve të mëtutjeshme në zero. Për më tepër, kostot e aprovuara nga rregullatori kanë marrë për bazë çmimet aktuale të vitit 2011 dhe ato asnjëherë nuk janë përshtatur për të reflektuar rritjen



reale të çmimeve aktuale. Në këtë këndvështrim, OSSh beson se nuk duhet të aplikohet asnjë faktor efikasiteti.

Për më tepër, duhet të theksohet se numri i konsumatorëve është vazhdimisht në rritje. Nga 470,000 konsumatorë aktivë sa ishin në vitin 2013, numri i konsumatorëve aktivë është rritur në mbi 561,000, gjë që ka rezultuar edhe në rritjen e kostove për ofrimin e shërbimeve për këtë numër të konsumatorëve. Në shembullin e mëposhtëm, kemi analizuar OPEX-in aktual për konsumatorë për vitin 2017 dhe nëse marrim parasysh tendencën për rritjen e konsumatorëve në vitin e ardhshëm, edhe nëse kostot e OPEX-it ulen për faktorin e efikasitetit prej 1.5% ashtu siç është propozuar nga rregullatori, vërehet se kostot aktuale të OPEX duhet të rriten për 2%.

Përshkrimi	2017	2018
OPEX-i aktual 2017	27,025,000	
Nr. mesatar i konsumatorëve	549,101	570,905
Kostot OPEX për konsumatorët	49.22	48.48
OPEX-i pritur	27,025,000	27,676,627
<b>Pritjet reale e rritjes/uljes se OPEX</b>		<b>2%</b>

Siç është theksuar në disa takime me ZRrE-në, çdo faktor efikasiteti i zbatuar në OPEX, veçanërisht në linjën e pagave, potencialisht do të reflektojë në zvogëlimin e numrit të punëtorëve dhe rrjedhimisht edhe në cilësinë e shërbimeve të ofruara. Pagat përbëjnë 80% të totalit të shpenzimeve operative dhe nëse marrim parasysh se shumica e kostove të tjera brenda shpenzimeve operative janë jashtë kontrollit të OSSh-së, zbatimi i faktorit të efikasitetit do të ndikojë drejtpërsëdrejti tek punëtorët dhe përkatësisht edhe në cilësinë e shërbimeve të ofruara. Duke marrë në konsideratë që ZRrE gjatë periudhës së dytë rregullative do të aprovoj rregullën e re për standardet e cilësisë së shërbimit, OSSh-ja nuk do të jetë në gjendje të përmbushë rezultatet e pritura, prandaj ZRrE duhet të merr parasysh reflektimin real të shpenzimeve gjatë përcaktimit të MAR-it përfundimtar për OSSh-në.

OSSH mendon se nuk duhet të zbatohet asnjë faktor efikasiteti as në pjesën e mirëmbajtjes, meqenëse aktualisht kostot e mirëmbajtjes paraqesin vetëm kostot e çmimit dhe blerjes së materialeve, pasi shumica e punëve të mirëmbajtjes bëhen përmes punëtorëve të brendshëm, kostot e të cilëve janë përfshirë tashmë në pjesën e pagave. Meqenëse OSSh ka ofruar një plan të detajuar të çmimeve aktuale dhe atyre të pritura, si dhe materialeve të detajuara që do të blihen për qëllime të mirëmbajtjes, kërkon të dijë se cilat pjesë janë ndryshuar nga ZRrE-ja krahasuar me kërkesën fillestare të propozuar nga OSSh-ja.

Në këtë këndvështrim, ju lutemi keni parasysh se OSSh-ja nuk ka fuqi dhe kontroll mbi çmimet e jashtme, prandaj aplikimi i çfarëdo norme të efikasitetit do të reflektojë menjëherë në zvogëlimin e planit të propozuar të mirëmbajtjes, apo madje edhe të numrit të punëtorëve. Siç u tha më lart numri i konsumatorëve është vazhdimisht duke u rritur, gjë që do të reflektojë edhe në rritjen e volumit të punës dhe respektivisht rritjes së kostove. Numri në rritje i konsumatorëve nënkupton edhe rritjen e rrjetit të shpërndarjes, ngarkesës më të lartë dhe respektivisht rrjedhje më e lartë e energjisë.



OSSH propozon një rritje prej 2% për kostot e mirëmbajtjes, duke filluar nga kostoja bazë për mirëmbajtje e propozuar nga Rregullatori, që të jetë gjendje t'i shërbej numrit në rritje të konsumatorëve (rreth 5% në vit) dhe kostove në rritje për ofrimin e shërbimeve dhe mirëmbajtjes, e të cilat kosto janë të nevojshme për rrjetin në rritje të sistemit të shpërndarjes, veçanërisht duke pasur parasysh rritjen e shitjeve, përkatësisht rrjedhën e energjisë (EED), për rreth 3% në vit.

Tabela në vazhdim përmbledh të dhënat aktuale për trendin në rritje të shitjeve, energjinë në hyrje të sistemit të shpërndarjes (EED), numrin e konsumatorëve dhe reflektimin e faktorit të efikasitetit në OPEX gjatë periudhës së parë rregullative.

Përshkrimi	2015	2016	2017
EED Aktuale (GWh)	4,676.5	4,806.8	4,996.6
Shitjet (GWh)	3,183.0	3,374.0	3,532.4
Numri I konsumatorëve	514,799.0	536,393.0	561,809.0
OPEX-i i aprovuar ('000 €)	26,208.33	25,089.03	23,810.50
Opex-i për shitjet MWh (€/Mwh)	8.23	7.44	6.74
<b>Efikasiteti I OPEX-it për MWh e shitur</b>		<b>-10%</b>	<b>-9%</b>
OPEX për MWh e shpërndarë	5.60	5.22	4.77
<b>Efikasiteti i OPEX-it për MWh e shpërndarë</b>		<b>-7%</b>	<b>-9%</b>
OPEX –i për konsumatorë	53.29	48.74	44.39
<b>Efikasiteti i OPEX-it për konsumatorë</b>		<b>-9%</b>	<b>-9%</b>

\*Shënim: OPEX-i i paraqitur këtu nuk llogarit ndarjen e duhur të kostove, ashtu siç kërkohet nga OSSH, por atë të miratuar nga ZRrE

Siç shihet në tabelën e mësipërme, përveç efikasitetit në OPEX, OSSH ka arritur optimizim të konsiderueshëm, të cilat nuk janë kompensuar me OPEX-in e dhënë gjatë periudhës së parë rregullative dhe që do të jetë problematike për t'u arritur në të ardhmen. Kjo analizë tregon se nuk duhet të zbatohet faktori i efikasitetit i propozuar nga Rregullatori për periudhën e dytë rregullative dhe për më tepër niveli i OPEX-it duhet të përshtatet për të pasqyruar kostot aktuale, duke pasur parasysh rritjen e numrit të konsumatorëve, konsumin e energjisë dhe zgjerimin e rrjetit, e veçanërisht për faktin se ky trend i rritjes është në vazhdim .

Në mënyrë të ngjashme, nëse analizojmë kostot e lëndëve djegëse (naftës) nga viti 2013 deri në vitin 2017, çmimi i naftës është rritur në baza vjetore, e cila nuk është marrë parasysh nga ZRrE-ja gjatë periudhës së parë rregullative, përkundrazi ka vazhduar aplikimi i faktorit të efikasitetit prej 5% dhe asnjëherë nuk u bënë përshtatjet e duhura. Kostot e pritshme parashikojnë gjithashtu një rritje të çmimeve, prandaj OSSH-ja në këtë aplikim parashikon një rritje prej 1.5% për të reflektuar rritjen e pritshme të çmimeve dhe rritjen e sasisë së shpenzuar të naftës, në përputhje me rritjen e punës së mirëmbajtjes dhe përdorimin e makinerive të reja të rënda. Për më tepër OSSH beson se çdo ndryshim në çmimet e naftës në vitet e ardhshme duhet të pranohet si i tillë nga rregullatori dhe duhet të pasqyrohet në procesin e përshtatjes vjetore, pasi që çmimet e lëndëve djegëse (naftës) janë jashtë kontrollit të OSSH-së.



ZRrE ka konsideruar me të drejtë një rritje të lehtë të OPEX-it për t'i reflektuar ndryshimet në sektorin e energjisë, megjithatë metodologjia e përdorimit të OPEX-it bazë nga OPEX i miratuar në vitin 2017 nuk është qasja e duhur. Pa marrë në konsideratë gabimet teknike të ZRrE-së gjatë aplikimit të OPEX-it bazë të vitit 2017, duhet theksuar se OPEX i miratuar në vitin 2017 bazohet në analizën e OPEX-it të bërë në vitin 2011, duke marrë parasysh kostot aktuale në atë kohë, si dhe numrin e punëtorëve të transferuar vetëm nga KEK-u. Sidoqoftë, OSSh gjatë periudhës 5 vjeçare kishte nevojë të punësonte punëtorë të rinj, veçanërisht për dhe gjatë procesit të shthurjes, të cilat nuk ishin marrë për bazë gjatë aprovimit të OPEX-it nga ZRrE-ja, prandaj gjatë këtij rishikimi periodik duhet të merret parasysh numri i saktë i të punësuarve dhe respektivisht i kostove përkatëse.

Për më tepër, në vitin 2014, siç është informuar edhe ZRrE-ja, punëtorët e OSSh-së kanë protestuar duke kërkuar rritje të pagave në përputhje me rritjen e aplikuar në ndërmarrjet publike të sektorit të energjisë. OSSh-ja arriti të zgjedh këtë çështje vetëm pas shumë takimeve dhe bisedimeve me sindikatën e punëtorëve dhe pas shumë bojkotimeve të punës nga punëtorët, duke rritur pagat e punëtorëve të cilët kishin pagën bruto më pak se 500 €/ muaj me një shtesë prej 30 €/muaj për punëtorë, kosto këto të cilat asnjëherë nuk u morën parasysh në OPEX-in e lejuar të OSSh-së, e të cilat paraqiten një barrë shtesë për OSSh-në marr parasysh se faktori i efikasitetit prej 5% tashmë ishte duke u zbatuar.

Në këtë kuptim, OSSh i propozon ZRrE-së që të shqyrtojë edhe një herë OPEX-in, duke marrë parasysh kostot aktuale të realizuara gjatë vitit 2017, për vitin fillestar të periudhës së dytë rregullative (viti 2018). OSSh për më tepër mendon se një rritje reale e pagave do të zvogëlon diferencën e lartë me ndërmarrjet e tjera publike të sektorit të energjisë. Për më tepër çfarëdo rritje e mundshme e pagave në sektorin publik në të ardhmen, në kuptim të veprimtarisë së njëjtë operuese, duhet të trajtohet njësoj edhe për punëtorët e OSSh-së. OSSh tutje kërkon nga ZRrE të pasqyrojnë inflacionin aktual të aplikuar në Kosovë duke pasur parasysh se punëtorët jetojnë në Kosovë dhe respektivisht shpenzojnë pagat e tyre në Kosovë. Kjo ishte kërkesa e OSSh-së në çdo proces të përshtatjeve vjetore, por asnjëherë nuk u shqyrtua nga ZRrE-ja. OSSh beson se përshtatja për inflacionin duhet të bëhet duke marrë parasysh inflacionin e Kosovës në vend të atij evropian.

Ndërkohë, OSSh do të pasqyrojë kostot aktuale për OPEX, pa i zbritur të hyrat nga Furnizuesi me Shërbim Universale (FShU) për shërbimet e përbashkëta, ndërsa të hyrat nga FShU do të zbriten tek të hyrat shtesë, në përputhje edhe me pasqyrat financiare. Një qasje e tillë do të përfaqësojë reflektimin aktual të kostove të operimit, ndërkohë që nuk do të ketë asnjë ndikim në MAR-in përfundimtar apo në vet sistemin.

Historikisht OPEX-i është rialokuar në mes të OSSh dhe Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (FP EE) në vitin 2014 me shthurjen e tyre. Në vitin 2016 dhe 2017, të dy entitetet rialokuan dhe ri-caktuan kostot direkte të atribuara, duke e mbajtur OPEX-in e përgjithshme për OSSh dhe FP EE-në (tash FShU-në) të pandryshuar, brenda objektivave të ZRrE-së bazuar në alokimin përfundimtar të obligimeve dhe operimeve ndërmjet dy mbajtësve të licencave. Në këtë kuptim, kostot totale, duhet të rialokohen ndërmjet OSSh-së dhe FShU-së, i cilin rialokim tashmë është bërë përmes aplikimit të OSSh-së dhe FShU-së në shtator të vitit 2017. Rialokimi nuk ndikon në rritjen e çmimeve të konsumatorëve fundor, por pasqyron alokimin duhur të kostove.



Siç shihet në tabelën më poshtë, bazuar në të dhënat aktuale dhe të aprovuara për vitin 2017, rialokimi ndërmjet OSSh-së dhe FShU-së është 1.5 milion €, e cila duhet të aplikohet saktë për të reflektuar alokimin e duhur ndërmjet OSSh-së dhe FShU-së:

Përshkrimi	OSSh	FShU	Total
<b>Alokimi i OPEX-it në mënyrë të saktë</b>	<b>27.03</b>	<b>3.53</b>	<b>30.56</b>
Shërbimet e përbashkëta	-1.50	1.50	0.00
<b>OPEX –i neto</b>	<b>25.525</b>	<b>5.03</b>	<b>30.56</b>
OPEX-i i aprovuar	23.83	5.83	29.67
Diferenca	1.69	-0.80	0.89

Bazuar në analizën e detajuar të OPEX-it të siguruar nga rregullatori dhe nëse marrim parasysh pagat aktuale të vitit 2017, mbeten vetëm 2 milionë € për të mbuluar të gjitha shpenzimet e tjera, si shpenzimet për lëndët djegëse (e cila është një pjesë e rëndësishme e OPEX-it të OSSh-së), sigurimet, trajnimet dhe ngritjet e kapacitetit të punëtorëve, etj. Siç është arsyetuar më sipër dhe nëse marrim parasysh kostot aktuale të realizuar gjatë viteve 2013-2017, këto kosto llogariten prej 4-5 milionë € në baza vjetore, andaj ZRrE duhet të reflektoj këtë nevojë. Për më tepër, OSSh ka rritur edhe kostot e tjera për 2% në baza vjetore, në mënyrë që të pasqyrojnë kostot aktuale të ofrimit të këtyre shërbimeve.

Njëherazi, për shkak të ndryshimeve në legjislacionin primar dhe sekondar dhe hapjen e tregut, linja 'shërbime të telekomunikimit dhe internetit' (e përfshirë në linjën 'të tjera' ), duhet të llogarit edhe një rritje shtesë në krahasim me kostot mesatare të realizuara në periudhën e parë rregullative, sepse:

- duhet të ndërtohet dhe zhvillohet një sistem i ri për të akomoduar ngritjen e kërkesave të të dhënave për funksionimin e tregut,
- kemi shërbime shtesë në lidhje me grumbullimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave për konsumin për çdo orë, në lidhje me kërkesat e ardhshme të profilit të ngarkesës,
- shpenzimet e operimit për mbajtjen e softuerëve dhe pajisjeve janë rritur gjatë këtyre viteve së bashku me shpenzimet e tjera të mirëmbajtjes,
- nevojitet zhvillim i mëtejshëm i sistemit SCADA, GIS, OMS dhe DMS

Prandaj, ne besojmë se këto kërkesa duhet dhe do të pasqyrohen nga rregullatori gjatë rishikimeve përfundimtare, siç është propozuar nga OSSh, e cila është paraqitur në tabelën e mëposhtme:



€000s	----- PRR2 -----				
	2018	2019	2020	2021	2022
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
<b>Propozimet e ZRrE-së</b>					
Riparimet dhe Mirëmbajtja	4,032	3,971	3,911	3,853	3,795
Shpenzimet tjera operative	21,418	21,152	20,892	20,637	20,387
Qiraja për asetet e Trepçës	246	246	246	246	246
Kostot e bartshme	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Total OPEX	25,696	25,369	25,049	24,735	24,428
<b>Propozimet e reja nga OSSh</b>					
Riparimet dhe Mirëmbajtja	4,032	4,092	4,154	4,216	4,279
Shpenzimet tjera operative	24,579	24,984	25,371	25,764	26,165
Qiraja për asetet e Trepçës	246	246	246	246	246
Total OPEX	28,857	29,322	29,771	30,227	30,691
Shërbimet e përbashkëta	-1500	-1500	-1500	-1500	-1500
OPEX-i neto	27,357	27,822	28,271	28,727	29,191
<b>Diferenca ndërmjet propozimit të ZRrE-se dhe OPEX-it neto</b>	<b>1,661</b>	<b>2,452</b>	<b>3,221</b>	<b>3,991</b>	<b>4,762</b>

#### IV. Bilanci i Energjisë Elektrike

ZRrE ka përdorur me saktësi volumet e energjisë elektrike siç janë parashikuar nga OSSh, megjithatë energjia në hyrje të sistemit të shpërndarjes (EED) llogaritet në bazë të nivelit të lejuar të humbjeve, që matematikisht është korrekt, por që realisht nuk përfaqëson EED aktuale të pritur për vitin 2018.

Në bilancin e energjisë elektrike të miratuar për vitin 2017<sup>1</sup> (dhe ne supozojmë se e njëjta metodë është përdorur edhe në bilancin e energjisë elektrike të pa publikuar por të aprovuar për vitin 2018), ZRrE ka konsideruar nivelin aktual të humbjeve gjatë përcaktimit të EED-së së pritur për vitin përkatës.

Ne pajtohemi që ZRrE-ja për qëllime tarifore do të dhe duhet të përdorë nivelin e lejuar të humbjeve, megjithatë për të shmangur përshtatjet e mëdha për volumet e humbjeve (siç ndodhi në vitin 2017) , e të cilat do të kthehen duke aplikuar normën e interesit në vitin e ardhshëm, ne sugjerojmë të përdorim vlerën reale të pritur të EED-së për vitin përkatës 2018 dhe më tutje. Për më tepër, bilanci i energjisë i

<sup>1</sup> Bilanci energjetik i aprovuar për vitin 2017, <http://ero-ks.org/2017/Sektoret/Bilanci%20Vjetor%20i%20Energjis%C3%AB%20Elektrike%20dhe%20Termike%20p%C3%ABr%20vitin%202017.pdf>





përdorur për qëllime tarifore duhet të jetë në përputhje me bilancin e energjisë të miratuar, i cili përfaqëson rrjedhat reale të energjisë në sistemin e energjisë elektrike.

€000s	Njësia	----- PRR2 -----				
		2018	2019	2020	2021	2022
		Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
<b>Propozimet e ZRrE-së</b>						
Energjia në hyrje të shpërndarjes	GWh	4,539	4,642	4,638	4,636	4,630
Humbjet e lejuara	%	18.80%	18.80%	17.60%	16.40%	15.10%
Humbjet	GWh	853	873	816	760	699
Çmimi i blerjes së energjisë me shumicë	€/MWh	42	40	40	40	40
<b>Kostot totale te blerjes se humbjeve</b>	<b>€000s</b>	<b>35,844</b>	<b>34,906</b>	<b>32,650</b>	<b>30,412</b>	<b>27,964</b>
<b>Propozimi i ri nga OSSh</b>						
Energjia në hyrje të shpërndarjes	GWh	4,762	4,803	4,826	4,851	4,883
Humbjet e lejuara	%	18.80%	18.80%	17.60%	16.40%	15.10%
Humbjet e tejkaluara	%	3.8%	2.7%	3.2%	3.7%	4.4%
Humbjet aktuale të pritshme	%	22.60%	21.53%	20.82%	20.11%	19.51%
Humbjet e lejuara	GWh	895	903	849	796	737
Çmimi i blerjes së energjisë me shumicë	€/MWh	42	40	40	40	40
<b>Kostot totale te blerjes se humbjeve</b>	<b>€000s</b>	<b>37,603</b>	<b>36,120</b>	<b>33,977</b>	<b>31,824</b>	<b>29,496</b>

Duhet theksuar se vetëm për periudhën janar-korrik 2017 EED-ja aktuale është 2,966 GWh. Nëse marrim parasysh trendin e njëjtë deri në fund të vitit 2018, ose të dhënat aktuale për vitin 2017 nga gushti deri në dhjetor 2017, EED-ja e pritur për vitin 2018 është mbi 5,000 GWh, e që është afër EED-së së realizuar në vitin 2017 prej 4,996 GWh.

Siç u theksua më lartë dhe bazuar në Rregullën për të hyrat e OSSh-së, ky ndryshim do të trajtohet si përshtatje duke aplikuar edhe normën e interesit në shqyrtimin e ardhshëm të përshtatjeve vjetore. Në këtë kuptim, për të qenë të drejtë dhe për të shmangur përshtatjet e mëdha në vitet e ardhshme, OSSh sugjeron të aplikoj vlerat e sakta kur llogaritet EED për vitin 2018 dhe më tej.



Nëse kjo qasje nuk zbatohet në mënyrë korrekte nga rregullatori, kjo do të detyrojë OSSH të financojë sektorin në vitin relevant t, derisa të aplikohen përshtatjet në vitin e ardhshëm relevant, duke përkeqësuar kështu edhe më tej pozitën financiare të OSSH-së në këtë vit relevant.

## V. Baza e Aseteve të Rregulluara

Në këtë pjesë, OSSH do të japë komentet mbi përshtatjet e investimeve kapitale të realizuara në periudhën e parë rregullative, si dhe investimet kapitale që priten të zbatohen në periudhën e dytë rregullative.

### *V.i. Baza e Aseteve të Rregulluara për Periudhën e Parë Rregullative– Përshtatjet*

Në përgjithësi pajtohem me ZRrE-në dhe parimet e përshtatjeve megjithatë, OSSH ka vërejtur disa gabime teknike, të cilat duhet të shqyrtohen nga ZRrE-ja gjatë përcaktimit të MAR-it përfundimtar. OSSH ka vërejtur se ZRrE ka bërë një gabim teknik gjatë llogaritjes së zhvlerësimit të jetëgjatësisë së asetëve për asetet para PRr 1, respektivisht për vitin 2018 ka llogaritur kostot e zhvlerësimit dhe kthimit duke përfshirë pjesën e mbetur të jetëgjatësisë së asetëve gjatë vitit 2017, e cila duhet të korrigjohet. Në mënyrë të ngjashme për asetet e zhvlerësuar me 20 vjet, ZRrE ka përdorur vetëm inflacionin vjetor, krahasuar me zhvlerësimin e asetëve për 35 dhe 5 vite për të cilat ka përdorur normën e përbërë të inflacionit. Korrigjimet e tilla janë zbatuar në mënyrë të saktë nga OSSH-ja në këtë aplikim.

Sidoqoftë, OSSH ka vërejtur se ZRrE ka aplikuar normën e përbërë të interesit gjatë përshtatjeve të kostove të zhvlerësimit dhe kthimit, për të cilën qasje OSSH nuk pajtohet, meqë ishte vendimi i ZRrE-së që të mos e bënte përshtatjen e zhvlerësimit dhe kthimit në baza vjetore, edhe pse kjo ishte kërkesë e OSSH në aplikimet e saj, andaj aplikimi i normës së përbërë të interesit në diçka që nuk ishte në kontrollin e OSSH-së nuk është qasje e drejtë.

OSSH kërkon që ZRrE-ja gjithashtu të bëjë përshtatjen e investimeve të zbatuara gjatë vitit 2017, pasi të dhënat e përdorura nga rregullatori bazohen në të dhënat e ofruara nga OSSH-ja në shtator të vitit 2017, andaj viti 2017 përfaqëson vlerat e parashikuara dhe jo ato të sakta.

Për më tepër, OSSH ka vënë re se ZRrE ka përdorur normën e njëjtë të zhvlerësimit të asetëve para PRr2 me atë që e ka aplikuar edhe në PRr1, megjithatë për WACC ka aplikuar normat e reja të aprovuara. Në këtë kuptim, me vendimin e ri për zhvlerësimin e jetëgjatësisë dhe WACC-un, OSSH kërkon nga rregullatori që për asetet para PRr2 të përdorë ose të njëjtën normë të zhvlerësimit të jetëgjatësisë së asetëve dhe WACC sikurse në PRr1, ose të përdorë normat të reja për zhvlerësimin e jetëgjatësisë së asetëve dhe WACC-un për të gjitha investimet. Ju lutem vini re se normat e WACC-ut dhe zhvlerësimit janë dhe duhet të zbatohen në mënyrë konsistente për të gjitha investimet.



## *V.ii. Baza e Aseteve të Rregulluara për Periudhën e Dytë Rregullative*

Siç është specifikuar në fillim të dokumentit, procesi i shqyrtimit shumëvjeçar ka filluar në maj të vitit 2017. Në këtë pikëpamje dhe me të dhënat e njohura në kohën e aplikimit, dhe në përputhje me planin zhvillimor 10 vjeçar (Master Planin), OSSh ka përgatitur Planin e Investimeve për vitet 2018-2022, të cilat i janë dorëzuar në ZRrE-së për miratim, së bashku me analizën e kostos dhe përfitimit (Cost/Benefit Analysis) ashtu siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Plani i investimeve ishte i përbërë nga Projektet e Master Planit, përforcimi i rrjetit, Sistemi Scada, njehsorët, makineritë e rënda dhe projekte të tjera (TI, pajisje të posaçme për operimin në terren etj.), të cilat në total llogaritin një kosto prej 153 milionë €, nga të cilat 29 milionë € ishin parashikuar të investohen në vitin e parë të periudhës së dytë rregullative (2018).

Megjithatë, për shkak të vonesave në procesin e shqyrtimit, OSSh ishte udhëzuar për të investuar jo më shumë se 22 milionë €, marrë parasysh paqartësinë e situatës, pasi parametrat do të vendoseshin në fund të vitit 2018. Duke marrë parasysh këto pasiguri dhe mundësinë që ZRrE-ja mund të ndryshojë projektet nga ato siç u kërkuan fillimisht, OSSh ishte shumë i kujdesshëm me investimet në vitin 2018. Për më tepër, investimet e mëdha kërkojnë procedura të hershme të tenderimit, prandaj shumë projekte të parashikuara për vitin 2019 janë mbyllur pothuajse, e të cilat vendime do të ndikojnë gjithashtu edhe në nivelin e investimeve totale që do të zbatohen në vitin 2019.

Siç u tha më parë, investimet prej 153 milion € ishin planifikuar bazuar në parametrat e propozuar nga OSSh, e të cilat do të mundësonin financim të mjaftueshëm për të arritur të gjitha objektivat dhe respektivisht nivelin e propozuar të investimeve.

WACC-u i aprovuar nga ZRrE e ka vënë OSSh-në në një situatë financiare jo të favorshme, pasi financimi lokal i investimeve për një periudhë 2-5 vjeçare, bazuar në të dhënat e dhëna nga Banka Qendrore e Kosovës në dhjetor të vitit 2017, tashmë ishte në nivel prej 8%. Për më tepër, në kuptim të rënies së theksuar të parametrave, bankat nuk shohin siguri të mjaftueshme për të dhënë kredi te reja ose për të zgjatur periudhën më shumë se 5 vjet, andaj financimi i këtyre investimeve nuk është premtues, pasi që burimet e financimit janë vështirë për tu gjetur.

Meqenëse, ZRrE nuk e ka marrë parasysh letrën për rihapjen e procesit të aplikimit të MAR, OSSh do të kërkojë një rishikim të planit të investimeve, me rreth 61 milionë€ investime për periudhën e dytë rregullative, me qëllim që të sigurohet se kompania do të jetë në gjendje të vazhdojë të operoj pa brengen e falimentimit. Normalisht, brenga e falimentimit të mundshëm dhe qëndrueshmëria financiare e kompanisë duhet të sigurohet nga rregullatori duke lejuar burime të mjaftueshme financiare nëpërmjet MAR-it, gjë që nuk po ndodh me parametra aktual të aprovuara dhe nivelet e propozuara të OPEX-it dhe normës së propozuar të efikasitetit. Në këtë kuptim, OSSh-ja është detyruar të rishikojë planin e investimeve dhe të propozojë një strukturë të re të investimeve, të cilat do t'i paraqiten ZRrE së shpejti me të gjitha detajet përkatëse **për të diskutuar, me qëllim që të siguroj qëndrueshmëri të operimeve nën vlerat hyrëse të aprovuara për PR2**



OSSH ka vërejtur tutje se disa projekte, të cilat janë paraparë si një zgjidhje e përkohshme ndaj vonesave në zgjerimin e rrjetit të transmisionit dhe investimeve të tyre, janë shtuar në planin e propozuar të Investimeve Kapitale të OSSh-së dhe të cilat pritet të zhvlerësohen për 30 vjet, me gjithë faktin se këto projektet do të bëhen pothuajse të papërdorshme pas përfundimit të investimeve nga OST-së në periudhën e dytë rregullative. Megjithatë, investimet e tilla nuk do të konsideroheshin asnjëherë në planin e OSSh-së, dhe sidomos tani kur OSSh-ja po përballet me vështirësi në gjetjen e burimeve për financimin e investimeve të saj, OSSh-ja nuk mund ta pranojë këtë propozim nga ZRrE, përveç nëse këto investime zhvlerësohen përmes tarifave deri në përfundimin e projekteve të OST, pra fundi i vitit 2022. Për më tepër, duhet theksuar se kostot e propozuara të investimeve të përfshira në Investimet e OSSh-së nuk përfaqësojnë vlerësimin e kostove të ofruar nga OSSh-ja, prandaj në rast se ZRrE konsideron se këto investime duhen të kryhen nga OSSh, duhet të marrë parasysh shpenzimet e duhura, ashtu siç janë paraqitur në planin e harmonizimit.

Në këtë kuptim, dhe duke marrë parasysh nivelin e lejuar të humbjeve, i cili ndryshon nga ai i sugjeruar dhe i pritur gjatë zhvillimit të planit të investimeve të OSSh-së, OSSh-ja do të ketë nevojë për projektin e njehsorëve të mençur, për të cilat do të dorëzohet një studim fizibiliteti të detajuar ashtu siç kërkohet nga ZRrE-ja.

Në këtë raport OSSh do të marrë parasysh planin e ri të Investimeve për periudhën e dytë rregullative, që llogaritet në vlerë prej 61 milion €, siç paraqitet në tabelën e mëposhtme:

€000s	Total	----- PRR2 -----				
		2018	2019	2020	2021	2022
		Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Plani i ri i rishikuar i Investimeve						
Investimet kapitale	<b>61,129</b>	20,323	11,233	10,021	9,776	9,776

Plani i rishikuar i investimeve merr parasysh nivelet e kredive që mund të merren në treg, me parametrat e pafavorshëm të WACC-ut dhe parametrat e humbjeve të aprovuara nga Rregulatori dhe përqendron të gjitha investimet në iniciativat për reduktimin e humbjeve, duke kufizuar investimet e tjera në minimumin e nevojshëm për të mbajtur kompaninë në operim. Në këtë këndvështrim, gjithashtu projektet e Master Planit do të duhet të shtyhen derisa të krijohen nivelet e duhura të WACC dhe caqet e humbjeve, të cilat do të mundësojnë gjenerimin e parave të nevojshme për përfundimin e tyre.

Bazuar në modelin e OSSh dhe parametrat e aprovuara për WACC dhe Humbje, investimet e reja të propozuara së fundi, kërkojnë nevojë për kredi në vlerë prej 70 milion €, duke shkaktuar 12.5 milion € interes, pasi ato nuk mund të financohen me para të gjeneruara vetë. Kjo është në shkëlqim të plotë me strukturën e propozuar të leverazhit (gearing) 60/40 sipas legjislacionit sekondar, e që do duhej të siguronte stabilitetin financiar për operatorin.

Duhet të theksohet se ZRrE-ja për periudhën e dytë rregullative ka propozuar një kategorizim ndryshme për jetëgjatësinë e Aseteve, i cili megjithatë ende nuk është i ngjashëm me parametrat e jetëgjatësinë së



Aseteve të përdorura për çështje të kontabilitetit apo edhe ato aktuale, është shumë më afër tyre krahasuar me kategorizimin e përdorur në periudhën e parë rregullative. Jetëgjatësia e njëjtë e propozuar nga ZRrE është përdorur nga OSSh për të llogaritur zhvlerësimin dhe kthimin për periudhën e dytë rregullative. Megjithatë, ato të përdorura nga OSSh në këtë raport bazohen në investimet e rishikuara të propozuara, siç u shpjegua më lartë.

€000s	Total	----- PRR2 -----				
		2018	2019	2020	2021	2022
		Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Plani i ri i rishikuar i Investimeve						
Zhvlerësimi	<b>63,315</b>	13,319	12,882	11,816	12,373	12,926
Kthimi	<b>58,840</b>	11,396	11,820	11,877	11,894	11,854

## VI. Të hyrat jo-tarifore dhe kostot e përjashtuara

Në periudhën e parë rregullative ZRrE nuk ka parashikuar të hyra jo-tarifore gjatë përcaktimit të MAR-it, megjithatë përshtatjet janë bërë në baza vjetore duke aplikuar normën e interesit konform legjislacionit sekondar. OSSh-ja për periudhën e dytë rregullative ka parashikuar që edhe të hyra jo-tarifore të përfshihen në parashikimin e MAR-it, megjithëse vazhdimisht ka kërkuar që t'i mbajë këto të hyra, duke përjashtuar kostot e shkaktuara nga OSSh-ja përmes tarifave për realizimin e tyre. Kjo kërkesë asnjëherë nuk është marrë parasysh nga ZRrE gjatë periudhës së parë rregullative.

OSSH vazhdon të besojë se këto të hyra duhet t'i mbeten OSSh-së, madje ka arsyetuar disa herë se për disa shërbime, siç janë shërbimet e telekomit, OSSh-ja nuk ka ndonjë përfitim por është i detyruar të vazhdojë t'i ofrojë këto shërbime, për shkak të marrëveshjeve të trashëguara nga mbajtësi i mëparshëm i licencës. Duhet të theksohet se këto shërbime jo vetëm që nuk ofrojnë përfitime për OSSh-në por ato krijojnë shpesh edhe probleme në rrjet, veçanërisht kur kabllo të rrjetit të shpërndarjes shkëputen rastësisht nga kontraktorët e telekomit gjatë kryerjes së punës së tyre.

Për më tepër, siç është specifikuar çdo vit gjatë periudhës së parë rregullative, me qëllim që të ofrohet një përfitim për OSSh-në për zgjerimin e mëtejshëm të shërbimeve, atëherë të paktën duhet të aplikohet një faktor ndarës, përndryshe OSSh-ja nuk ka ndonjë përfitim për ofrimin e disa shërbimeve të veçanta, dhe nëse nuk shqyrtohet nga ZRrE për periudhën e dytë rregullative, OSSh do të shqyrtojë seriozisht mundësinë e anulimit të këtyre kontratave sapo t'u skadojë afati i tyre.

Për më tepër, ZRrE në propozimin e saj ka ulur OPEX-in për kostot e përjashtuara prej 408 mijë, të cilat duhet t'i mbeten OSSh-së nëse do të zvogëlohen të hyrat e parregulluara nga MAR-i. Propozimi fillestar i OSSh-së për zbritjen e këtyre kostove nga OPEX-i ishte bërë duke marrë parasysh aprovimin e



Metodologjisë së re të Taksave për Kyçje, e cila do t'i lejonte OSSh-së të mbajë të hyrat për ofrimin e shërbimeve të tilla.

Meqenëse ZRrE nuk parashikon miratimin e tij, pasi zbret nga MAR-i të hyrat e parregulluara, OSSh duhet të vazhdojë t'i ketë të përfshira këto kosto brenda në OPEX, pasi në të kundërt do të goditet dy herë. Në këtë këndvështrim, në përputhje me pritjet e ZRrE-së, OSSh do t'i mbajë këto kosto në OPEX, derisa Metodologjia e Taksave për Kyçje të miratohet dhe të jetë funksionale. Është e rëndësishme të theksohet gjithashtu se shpenzimet për ofrimin e shërbimeve të tilla mund të ndryshojnë në të ardhmen varësisht nga koha e miratimit të metodologjisë dhe të hyrave.

## VII. Përshtatjet e rregullta për vitin 2017 dhe për Periudhën e Parë Rregullative

Në këtë pjesë ZRrE ka përdorur disa përshtatje për të cilat OSSh dëshiron të japë komente dhe sa herë që beson se korrigjimet duhet të jenë të ndryshme nga ato të përdorura nga rregullatori, do të ofroj justifikime të mjaftueshme të cilat do të shqyrtohen nga ZRrE-ja para se të përcaktohet MAR-i për periudhën e dytë rregullative.

### VII.i. Përshtatjet për normën e inflacionit

ZRrE ka aplikuar përshtatjet për normën e inflacionit për OPEX-in, zhvlerësimin dhe kthimin duke pasur parasysh inflacionin e BE-së. Siç shpjegohet në fillim të dokumentit, OSSh beson se mënyra e duhur për të pasqyruar kostot aktuale është aplikimi i inflacionit të Kosovës, prandaj në këtë aplikim merr parasysh përshtatjet duke aplikuar normën e inflacionit në Kosovë, siç tregohet në tabelën e mëposhtme. Për më tepër, OSSh ka vënë re se ZRrE ka bërë një gabim teknik gjatë përshtatjeve të OPEX-it për vitin 2017, i cili u korrigjua për t'u aplikuar saktë nga OSSh dhe si i tillë duhet të konsiderohet edhe nga ZRrE gjatë shqyrtimeve përfundimtare.

Përshkrimi	Njësia	Të lejuara	HICP	Përshtatjet për inflacionin
OPEX* -i i korrigjuar	mil€	23.88	1.5%	0.36
Zhvlerësimi	mil€	9.39	1.5%	0.14
Kthimi	mil€	15.99	1.5%	0.24
<b>Totali</b>	<b>mil€</b>	<b>49.27</b>		<b>0.74</b>



## VII.ii Vlerësimi i bilancit të energjisë elektrike të realizuar - Korigjimi në faturim

Viti 2017 është karakterizuar me shumë ndryshime në sektorin e energjisë. Që nga miratimi i ligjeve të reja në Sektorin e Energjisë në vitin 2016, ZRrE gjatë vitit 2017 ka shqyrtuar dhe miratuar të gjitha rregullat duke i përshtatur ato me kërkesat e domosdoshme për hapjen e tregut. Ndërkohë, ka pësuar ndryshime edhe struktura tarifore, si dhe filloi të funksionoj mekanizmi balancues, me gjithë vështirësitë e saj.

Të gjitha këto ndryshime detyruan të ndryshoj forma e raportimit dhe proceset e tjera të brendshme, të cilat ndikuan që raportimi i faturimit fillimisht të përcillet në ZRrE me disa gabime teknike në fillim të muajit janar 2018.

Faturimi i OSSh-së për qëllimet e MAR-it është dorëzuar në ZRrE gjatë procesit të përshtatjes vjetore në fillim të janarit të vitit 2018, i cili raport është përdorur nga ZRrE për përcaktimin e MAR-it për periudhën e dytë rregullative. Megjithatë, OSSh gjatë raportimit vjetor, në fund të janarit 2018 ka raportuar në mënyrë të saktë vlerat e faturimit, me të gjitha detajet relevante, por siç duket ZRrE nuk i ka përdorur përcaktuesit e faturimit të korigjuara gjatë procesit të përcaktimit të MAR-it për periudhën e dytë rregullative.

OSSH do të përcjell edhe një herë përcaktuesit e faturimit të korigjuara për vëmendjen dhe konsideratën e ZRrE-së, andaj pas përditësimit të të dhënave përshtatjet për shitjet e vitit 2017 më nuk do të jetë relevante, siç tregohet në tabelën e mëposhtme:

Bilanci i energjisë elektrike në OSSh	Njësia	2017 Realizimi	ZRrE	2017 Realizimi	OSSH
Hyrja e energjisë elektrike në nivel të shpërndarjes (EED)	GWh	4,996.6		4,997	
Energjia e pa-faturuar në Veri	GWh	265.3		265.3	
Energjia e pa-faturuar në Veri	%	5.3%		5.3%	
<hr/>					
Humbjet teknike dhe komerciale në nivel tëshpërndarjes	GWh	1,199.0		1,199.0	
	%	24.0%		24.0%	
<hr/>					
<b>Energjia e mbetur për faturim</b>	<b>GWh</b>	<b>3,532.3</b>		<b>3,532.3</b>	
<hr/>					
<b>Faturimi nga OSSh</b>	<b>GWh</b>	<b>3,447.1</b>		<b>3,532.3</b>	
<hr/>					
<b>Korigjimi në faturim</b>	<b>GWh</b>	<b>85.2</b>		<b>0</b>	



### VII.iii Përshtatjet për të hyrat e parregulluara

Gjatë procesit të aplikimit në janar të vitit 2018, OSSh ka raportuar të hyrat e parregulluara nga kyçjet e reja në rrjetin e shpërndarjes, të hyrat nga qiraja, etj., në vlerë prej 5.7 milion € para aplikimit të normës së interesit, respektivisht 6.52 milion € për t'u përjashtuar në MAR-in e vitit 2018.

Bazuar në Raportet Financiare të hartuara dhe të mbyllura në mars të vitit 2018, ZRrE ka zbritur të hyrat totale të përdorura për qëllime kontabiliteti. Duhet të theksohet se pjesa 'Zvogëlimi i zhvlerësimit të asetëve fikse' të prezantuara në Raportin Financiar si të hyra për qëllime kontabiliteti, nuk duhet të konsiderohen si të hyra nga rregullatori gjatë përcaktimit të MAR-it, pasi kjo linjë nuk përfaqëson të hyra aktuale, respektivisht nuk është lëshuar asnjë faturë dhe përkatësisht nuk ka pasur qarkullim të parave.

Gjithashtu për pjesën "jo-balancat e energjisë" ne besojmë se rregullatori padrejtësisht ka zbritur të hyrat, pasi kjo pjesë paraqet përpjekjet e OSSh për të ndihmuar sistemin të qëndrojë në balancë. Kostot e jo-balancës kompensojnë koston e blerjes së energjisë për përmbushjen e nevojave të humbjeve dhe duhet të trajtohen së bashku me energjinë për humbje, e jo si të hyra të ndara. Nëse këto të hyra do të zbriten nga MAR-i i OSSh-së, atëherë ZRrE duhet të njohë edhe kostot e blerjes për humbjet e tejkaluara.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, përshtatjet për të hyrat e parregulluara duhet të jenë 5.3 milionë €.

### VII.iv. Përshtatjet për faktorin korigjues të të hyrave – KREV

Për shkak të gabimeve teknike të shpjeguara në detaje në kapitullin 'VII.ii. Vlerësimi i Bilancit të energjisë elektrike të realizuar - Korigjimi në faturim' shitjet aktuale janë konsideruar në mënyrë jo të duhur.

Pas aplikimit të vlerave korrekte, faktori korigjues KREV duhet të jetë 9.9 milion € në vend të 11.2 milion € siç paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Përshtatjet e KREV në mil €	ZRrE	OSSH
<b>MAR-i i aprovuar në 2017</b>	<b>67.53</b>	<b>67.53</b>
<i>Shitjet aktuale</i>	<i>75.35</i>	<i>76.18</i>
<i>Përshtatjet e bilancit</i>	<i>1.90</i>	<i>0</i>
<b>Shitjet totale</b>	<b>77.25</b>	<b>76.18</b>
<b>KREV me interes</b>	<b>11.17</b>	<b>9.94</b>





## VII.v. Përshtatjet për Humbjet

ZRrE ka përshtatur me të drejtë objektivat e humbjeve për 1.9%, të cilat ishin humbjet e trashëguara nga mbajtësi i mëparshëm i licencës dhe të cilat në periudhën e parë rregullative paraqiten një barrë shtesë për OSSh-në, mbi caqet agresive të vendosur për zvogëlimin e humbjeve.

Megjithatë, ZRrE-ja kur pranoi t'i njoh humbjet e trashëguara prej 1.9%, nuk kanë morri parasysh efektin e përbërë të tij gjatë periudhës së parë rregullative, për të cilën OSSh-ja kërkon kompensim këtë raport.

Vetëm 1.9% e EED-së aktuale për periudhën 5 vjeçare përfaqësojnë një kompensim prej 22.3 milionë € ndaj 453 GWh humbje, pa marrë në konsideratë edhe ndikimin në përshtatjet e aplikuar nga rregullatori, për të cilat OSSh ka bartë pasojat gjithashtu.

Përshkrimi	2013	2014	2015	2016	2017
EED aktuale	4,794	4,555	4,677	4,807	4,997
Efekti i 1.9% i humbjeve	91.09	86.54	88.85	91.33	94.94
Çmimi mesatar aktual	27.42	31.21	29.23	31.30	42.00
Kostoja neto e humbjeve që duhet të kompensohet	2,497	2,701	2,597	2,859	3,987
Norma e interesit	15.58%	15.58%	15.25%	14.87%	14.87%
Kostoja e humbjeve me normë interesi	5,151	4,820	3,975	3,772	4,580

## VII.vi. Përmbledhje e përshtatjeve

Tabela e mëposhtme përmbledh përshtatjet e rregullta për vitin 2017 dhe për periudhën e parë rregullative, në përputhje me shpjegimet dhe argumentet e dhëna më lartë. Për përshtatjet e komponentëve të kostove për të cilat OSSh-ja pajtohet me përshtatjet e ZRrE-së, nuk janë dhënë komente dhe respektivisht ato janë përdorur siç i ka përdorur rregullatori:



Përshtatjet e komponentëve të kostove në milë	ZRrE	OSSH
inflacioni	0.69	0.74
Kostot e bartshme	-0.08	-0.08
Kostot e humbjeve	9.26	9.26
Korrigjimi I faturimit	-1.91	0.00
Të hyrat e parregulluara	-8.52	-5.31
KREV	-9.26	-9.94
Përshtatje të tjera teknike	1.29	1.29
Përshtatjet e humbjeve	0.00	22.3
<b>Totali</b>	<b>-8.53</b>	<b>18.26</b>

Përshtatjet e përgjithshme që duhet të zbatohen në periudhën 5 vjeçare janë 18.3 milion €, përkatësisht 3.65 milion € për çdo vit të periudhës së dytë rregullative (2018-2022).

### VIII. Të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSh në bazë të kërkesave të OSSh-së

Kërkesat e arsyeshme dhe të argumentuara në këtë dokument janë përmbledhur si më poshtë:

- Mos-aplikimi i faktorit të efikasitetit në shpenzimet operative dhe reflektimi i saktë i kostove, duke marrë parasysh gjendjen aktuale të tregut në Kosovë;
- Aplikimi i normës së inflacionit të Kosovës për të gjitha kalkulimet;
- Aplikimi i saktë i bilancit të energjisë, duke u bazuar në rrjedhat aktuale të energjisë;
- Përdorimi i faktorit ndarës 50-50 për të hyrat jo-tarifore
- Aplikimi i saktë i jetëgjatësisë së mbetur të asetëve të periudhës së parë rregullative;
- Aplikimi i jetëgjatësisë së asetëve të miratuara së fundi edhe për asetet e periudhës së parë rregullative ose aplikimi i WACC-ut për 12% bazën e asetëve të periudhës së parë rregullative;
- Kompensimi për 1.9% të humbjeve të njohura në periudhën e dytë rregullative për 5 vitet e periudhës së parë rregullative;
- Aprovimi i Investimeve Kapitale duke marrë parasysh pozitën financiare të kompanisë krijuara pas aprovimit të parametrave hyrëse për periudhën e dytë rregullative, për të diskutuar me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëri e operimeve nën vlerat hyrëse të aprovuara për PR2
- Korrigjimi i përshtatjeve të periudhës së parë rregullative dhe vitit 2017;



Duke marrë parasysh arsyetimin për komponentët e kostove të paraqitura në seksionet e mësipërme të këtij dokumenti, të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) të propozuara për periudhën e dytë rregullative duhet të jenë, si në vijim:

€000s	PRR2				
	2018	2019	2020	2021	2022
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
OPEX	28,857	29,322	29,771	30,227	30,691
Shërbimet e përbashkëta	-1,500	-1,500	-1,500	-1,500	-1,500
OPEX-i neto	27,357	27,822	28,271	28,727	29,191
Kosto e humbjeve	37,603	36,120	33,977	31,824	29,496
Zhvlerësimi	13,319	12,882	11,816	12,373	12,926
Kthimi i Lejuar	11,396	11,820	11,877	11,894	11,854
Kostot e përjashtuara	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Kosot e bartshme	0.26	0.26	0.24	0.23	0.21
Të hyrat jo-tarifore	-1,750	-1,750	-1,750	-1,750	-1,750
Përshtatjet e nivelizuara 2017	3,652	3,652	3,652	3,652	3,652
Përshtatjet e nivelizuara për PRR2	-339	-339	-339	-339	-339
<b>Propozimi i ri i OSSh</b>	<b>91,239</b>	<b>90,208</b>	<b>87,505</b>	<b>86,382</b>	<b>85,031</b>

Duhet të theksohet se me aprovimin e rregullave të reja, krahasuar me periudhën e parë rregullative, shpenzimet operative dhe investimet kapitale do të përshtaten në baza vjetore, varësisht nga performanca e OSSh-së. Në këtë këndvështrim, duke marrë parasysh arsyetimet e lartpërmendura, por gjithashtu edhe faktin se çdo gjë do të përshtatet menjëherë në vitin e ardhshëm relevant, OSSh-ja nuk ka ndonjë përfitim për të kërkuar kosto më të larta, respektivisht shpenzime të pajustificueshme dhe jo të arritshme.

OSSH beson se kërkesa e vet është e drejtë dhe më e rëndësishmja e domosdoshme që sistemi i shpërndarjes të funksionojë siç duhet. Qëllimi i OSSh-së është të ofrojë shërbime më të mira për konsumatorët e vet, megjithatë për të bërë këtë duhet që kostot e nevojshme për operimit të lejohet dhe të mundësohen nga rregullatori.